



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

**PROPOZIM**

**R R E G U L L O R E**

**PËR**  
**ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E**  
**KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE**  
**LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË**  
**PRISHTINËS**

Poseduesi i dokumentit:	Për Sektorin:	Përgatitur më:	Miratur nga
Drejtoria Administratës	e Sektori i bashkësive lokale	17.11.2016	Drejtori i Administratës
		Ndryshuar më:	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

**PËRMBAJTJA**

PROPOZIM RREGULLORE .....	3
ANNEX 1 - Harta e bashkësive lokale të Komunës së Prishtinës pa emërtime të rrugëve .....	13
ANNEX 2-TERRITORET TË CILAT PËRFSHIHEN NË ÇDO BASHKËSI LOKALE.....	14
ANNEX 3- EMËRTIMET E RRUGËVE QË I TAKOJNË ÇDO BASHKËSIE LOKALE .....	20
BASHKËSITË LOKALE URBANE .....	20
BASHKËSITË LOKALE RURALE .....	21
EMËRTIMET E RRUGËVE.....	22



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, (" Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008"), Udhëzimit administrativ të MAPL, nr. 2008/08, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, dhe të neneve 7 dhe 8 të Statutit të Komunës, nr. 01.110.391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_, miratoi këtë

## R R E G U L L O R E

### PËR

### ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME

### FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

### NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS

#### **Neni 1** **Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të përcaktuara në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

#### **Neni 2** **Fushëveprimi**

Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis Komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duke formuar këshillat lokalë, si trupa mbështetës të organeve të Komunës, dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.



---

**Neni 3**  
**Formimi i këshillave lokalë**

1. Për të realizuar sa ma mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Komuna e Prishtinës do të mbështesë zgjedhjen e këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarët e këshillave lokalë. Një këshill lokal mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane.
2. Numri i këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane, do të themelohen në nivel të këshillave lokalë dhe do të paraqiten në listë të veçantë, shtojca nr. 1, që do të jetë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

**Neni 4**  
**Formimi i komisionit nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e këshillave lokalë**

1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë 7 anëtarë: 5 (pesë) anëtarë nga Kuvendi i Komunës, 1 (një) nga shoqëria civile dhe 1 (një) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Nga 7 anëtarët e Komisionit 3 (tre) duhet të jenë femra, si dhe 1 anëtar ose anëtare patjetër të jetë e Komunitetit jo shumicë. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit.
2. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve me qytetarë, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokalë dhe kryetarëve të këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
3. Së paku tre 3 anëtarë të komisionit të Komunës duhet të jenë të pranishëm në të gjitha tubimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokalë.
4. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokalë dhe kryetarëve të këshillave lokalë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



5. Të gjithë qytetarët pjesëmarrës në tubimin zgjedhore, mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhor. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, është i obliguar që t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe, brenda afatit prej 15 ditëve nga data e parashtrimit të kërkesës, t'u kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesa.

6. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, përmes Zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokalë, përmes:

6.1 shpalljeve publike, të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet për zgjedhjen e këshillave lokalë;

6.2 medieje lokale;

6.3 web-faqes zyrtare të Komunës.

Njoftimi për publikun duhet të përmbajë:

6.1 rendin e ditës,

6.2 datën,

6.3 kohën dhe

6.4 vendin e mbajtjes së tubimit.

7. Pas përfundimit të procesit zgjedhor të këshillave lokalë dhe kryetarëve të këshillave lokalë, komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës pushon aktivitetin.

## **Neni 5**

### **Formimi i këshillave lokalë dhe kriteret e për zgjedhjes**

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të ketë nga 5 deri në 9 anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill lokal, përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.

2. Çdo fshat, lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal. Në rast kur këshilli lokal ka numër qift të fshatrave, vendbanimeve, lagjeve urbane, atëherë vendbanimi, fshati, lagjja urbane me numër më të madh të banorëve jep dy anëtarë në këshillin lokal.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



3. Përbërja e këshillave lokalë duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30% të gjinisë femërore, sipas Ligjit për barazinë gjinore. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal nëse janë të pranishëm në tubim. Nëse kemi më shumë se një komunitet të pakicës, komuniteti që ka shumicën duhet të përfaqësohet në këshill lokal.
4. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës zgjedhin anëtarët e këshillit lokal me rastin e tubimit të qytetarëve, që mbledh të gjithë banorët e interesuar të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
5. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve.
6. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokalë duhet të jenë banorë të përhershëm në atë lokalitet.
7. Kandidatët për pozita të anëtarëve dhe të kryetarëve të këshillave lokalë, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur në poste politike.
8. Anëtarë të këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, zgjidhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.
9. Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, kandidati i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim.
10. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo më shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë organizohet rrethi dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjidhet për anëtarë, kryetar i këshillit lokal.
11. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç të atij lokaliteti. Numri i kandidatëve të propozuar për këshill lokal duhet të jetë më i lartë se numri i përcaktuar për t'u zgjedhur.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



- 
12. Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokalë të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, zgjidhën me mandat 3-vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.
  13. Tubimet e kanë legjitimitetin juridik, nëse në tubime janë të pranishëm së paku 50 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti, që duhet të përfshijë së paku 30% të gjinisë femërore.

**Neni 6**

**Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokalë**

1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë se anëtarët ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushur obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë të votave të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me rastin e tubimit publik me qytetarë.
2. Në mënyrë që të bëhet ky votim, kërkohet një petition për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ky petition duhet të mbledh nënshkrimet e më shumë se gjysma e numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Peticioni i dorëzohet Drejtorisë së Administratës dhe Sektorit për punë në Kuvend, të cilët pastaj e procedojnë tek anëtarët e Komisioni të formuar tek Neni 4 pika 1, të cilët anëtarë duhet të lajmërohen paraprakisht për një mbledhje të tillë.
3. Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet sipas procedurave të parapara në paragrafin 2, një votim i ri duhet të bëhet menjëherë, në bazë të procedurave të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në mënyrë që të zgjidhet një këshill i ri lokal. Rezultatet e votimit duhet të raportohen në bazë të kërkesave të nenit 6 të kësaj rregulloreje.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

4. Mandati i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokalë përfundon:

- 4.1 me kryerje të mandatit,
- 4.2 nëse vdes,
- 4.3 nëse jep dorëheqje,
- 4.4 nëse ndërron vendbanim,
- 4.5 nëse shkarkohet,
- 4.6 nëse kryen vepër penale.

**Neni 7**

**Procesverbali nga tubimi zgjedhor**

1. Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përmbajë: datën, orën dhe vendin e mbajtjes së tubimit, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, listën e pjesëmarrësve, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokalë, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.
2. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi i tubimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve dhe për zgjedhjen e këshillave lokalë të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
3. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve dhe të kryetarit të këshillit lokal, duhet të bëhen publike menjëherë pas tubimit zgjedhor.

**Neni 8**

**Konsultimet ndërmjet Komunës dhe këshillave lokalë**

1. Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës, ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim të politikave zhvillimore komunale që organizohen nga organet komunale.
2. Së paku një anëtar i këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për planifikim të planeve urbane, zhvillimore dhe rurale që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



3. Kryetari i Komunës duhet të organizojë së paku dy takime në vit me udhëheqësit e këshillave lokalë. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj. Për rendin e ditës duhet të konsultohen edhe udhëheqësit e këshillave lokalë.
4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

**Neni 9**

**Bartja e aktiviteteve nga komuna te këshillat lokalë**

1. Me kërkesën e këshillit lokal dhe rekomandimin e Kryetarit të Komunës, apo ndonjë komiteti të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim, mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokalë të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të transferohen, duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të Komunës.
2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga Komuna në këshillin lokal.
3. Në rast të bartjes së aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, komuna ofron mbështetje dhe burime të mjaftueshme për Zyrrat lokale/këshillat e fshatrave, vendbanimet dhe lagjet urbane me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartura.

**Neni 10**

**Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokalë**

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit, si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat, në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale.
3. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, duhet të informojë Komunën për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrrarët komunalë mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokalë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



4. Këshillat lokalë mund të formojnë nënkëshillat lokalë, bazuar në ndarjen e zonave dhe numrin e lokaliteteve të specifikuar në listën shtojcë, që është pjesë e kësej rregulloreje.
5. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
6. Këshilli lokal mund të ndërmarrë aktivitetet, të cilat në veçanti ndikojnë në:
  - 6.1. zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
  - 6.2. planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
  - 6.3. mbrojtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;
  - 6.4. rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
  - 6.5. sigurimin e të dhënave elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
  - 6.6. mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave publike të gjelbëruara;
  - 6.7. zhvillimin e turizmit;
  - 6.8. organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
  - 6.9. bashkëpunimin me organet e Komunës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile për çështjet me interes për lokalitetin;
  - 6.10. organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin;
  - 6.11. zbatimin e aktivitetet që janë të bartura, sipas procedurave të nenit 8 të kësaj rregulloreje.
7. Me vendim të Kryetarit të Komunës, një anëtar i këshillit lokal mund të jetë pjesë e organeve mbikëqyrës për monitorimin, zbatimin e projekteve për investimeve kapitale në lokalitetet e tyre.
8. Këshillat lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës përkatëse.
9. Këshillat lokalë kanë të drejtë t'u parashtrojnë kërkesë me shkrim organeve të Komunës për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, kurse organet e Komunës brenda afatit 30 ditësh, i përgjigjen me shkrim këshillit lokal.

### **Neni 11**

#### **Roli i kryetarëve të këshillave lokalë**

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e Komunës. Kryetari i Këshillit lokal ka obligim t'i informoj anëtarët e Këshillit për rezultatet ose konkluzionet nga takimet e përshkruara në paragrafin paraprak.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



- 
2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Po ashtu, ai i nënshkruan konkluzionet dhe propozimet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të tyre, t'i dorëzojë të Kryetari i Komunës.

**Neni 12**  
**Financimi i aktiviteteve**

1. Financimi i aktiviteteve të këshillave lokalë mund të bëhet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga Komuna, nga financimi i përbashkët, si dhe nga donatorët, në pajtueshmëri të plotë me Statutin, rregulloret komunale dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.
2. Këshilli lokal përgatit raporte gjashtë mujore dhe vjetore të mjeteve të arkëtuara dhe mjeteve të shpenzuara, dhe i bën ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti dhe organet komunale.
3. Këshillat lokalë janë të obliguar që të gjitha aktivitete e tyre financiare, t'i zhvillojnë përmes llogarisë bankare në emër të këshillit lokal.

**Neni 13**  
**Kompensimi i këshillave lokalë**

Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, përcaktohet nga Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë.

**Neni 14**  
**Mos përmbushja e përgjegjësive**

Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane përkatëse, mban obligime dhe përgjegjësi ligjore për të gjitha aktivitetet e bartura nga Kuvendi i Komunës në këshillin lokal.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

**Neni 15**

**Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare**

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e Ligjit dhe Statutit.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat , vendbanimet, dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, 01 nr. 110-1201, dt. 16.06.2010.

**Neni 16**

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

**Neni 17**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.
2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, Komuna është e obliguar të fillojë me zbatimin e kësaj rregulloreje.


**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

\_\_\_\_\_ nr. \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_.

**KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**Halim Halimi , jur.i dipl.**

\_\_\_\_\_

# ANNEX 1 - Harta e bashkësive lokale të Komunës së Prishtinës pa emërtime të rrugëve



QGIS  
 Punoi: Sebastian Sokoli  
 Tetor 2016, Prishtinë



---

ANNEX 2

TERRITORET TË CILAT PËRFSHIHEN NË ÇDO BASHKËSI LOKALE

- 1. BL 1 - "QENDRA"**, përfshin territorin duke filluar prej rrethrotullimit të Komunës, rrugës "Agim Ramadani, vazhdon me rrugën "Eqrm Çabej", vazhdon me bulevardin "Xhorxh Bush", vazhdon me rrugën "Garibaldi", rrugën "Driton Hoxha", vazhdon në rrugën "Tirana", rr. "UÇK" deri te pika fillestare te rrethrotullimi.
- 2. BL 2 - "LAKËRISHTA-PEJTONI"**, përfshin territorin duke filluar prej kryqëzimit të rrugës "Garibaldi" dhe bulevardit "Xhorxh Bush", vazhdon me bulevardin "Xhorxh Bush", "Bill Klinton", rrugën "Hekurudha", vazhdon me rrugën "Tirana", rrugën "Driton Hoxha" dhe rrugën "Garibaldi", deri në pikën fillestare në kryqëzim me bulevardin "Xhorxh Bush".
- 3. BL 3 - "DARDANIA"**, përfshin territorin duke filluar prej udhëkryqit mes bulevardeve "Dëshmorët e Kombit" dhe "Bill Klinton", rruga "5 Maji", rruga "Jusuf Gërvalla" te rrethi i madh për Fushë-Kosovë, deri te bulevardi "Bill Klinton".
- 4. BL 4 - "ULPIANA"**, përfshin territorin, duke filluar prej kryqëzimit të bulevardit "Bill Klinton" me rr. "Eqrem Çabej", "Afrim Zhitia", "Xhevë Lladrovci", vazhdon rruga "Femi Lladrovci", duke vazhduar me bulevardin "Dëshmorët e Kombit" deri te pikënisja.
- 5. BL 5 - "TOPHANE"**, përfshin territorin duke filluar prej kryqëzimit ku takohet rruga "Sami Plakolli" me rrugën "Ilir Konushevc", vazhdon me rrugën "UÇK", rruga "Zagrebi" deri në pikën fillestare.
- 6. BL 6 - "KALABRIA 1"**, (Sipas PZHU 1, 2, 4) e përfshin territorin prej rrethrotullimit për Fushë-Kosovë, rr. "Jusuf Gërvalla", rr. "Kadri Zeka", vazhdon me rrjedhën e lumit Prishtina, deri në kufi me Graçanicën dhe vazhdon me rrugën "Dëshmorët e Ponoshecit" deri te rruga "Peja" për të vazhduar deri në pikënisje.
- 7. BL 7 - "KALABRIA 2"**, përfshin territorin duke filluar prej kryqëzimit të rrugës "Kadri Zeka", rr. "Rilindja Kombëtare" vazhdon në drejtim të autostradës deri në kufi të komunës së Graçanicës, vazhdon përgjatë kufirit me Graçanicën deri te rrjedha e lumit Prishtina, rruga "Kadri Zeka" deri në pikën fillestare të nisjes.
- 8. BL 8 - "ÇAGLLAVICA 1"**, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës "Rilindja Kombëtare" rr. "Rafshi i Kosovës", vazhdon me rrugën





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



- “Ferizaj”, kufirin komunal të Gracanicës deri te autostrada, përgjatë rrugës “Rilindja Kombëtare” dhe kthehet deri në pikënisje.
9. **BL 9 - “ÇAGLLAVICA 2”**, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës së Gjilanit me rrugën “Rrafshi i Kosovës”, vazhdon me rrugën e Gjilanit, pastaj rrugën “Nekibe Kelmendi”, vazhdon me rrugën “Tom Lantosh”, pastaj rrugës “Elmi Hoti” deri në kufirin komunal Prishtinë – Gracanicë, deri te rruga “Rrafshi i Kosovës”, vazhdon në rrugën “Rrafshi i Kosovës” deri në kryqëzimin e pikënisjes.
10. **BL 10 - “HAJVALIA”**, Shashkoc, përfshin territorin duke filluar nga Fshati Ndërkombëtar, kryqëzimi i rrugës “Tom Lantosh” dhe rr. “Nekibe Kelmendi”, vazhdon në rrugën “Nekibe Kelmendi”, rruga “Pavarësia”, “Dëshmorët e Gollakut”, deri në kufirin komunal me Graçanicën, pjesën juglindore në drejtim të jugperëndimit deri në rrugën “Ilmi Hoti” dhe “Tom Lantosh” dhe vazhdon deri në pikën fillestare, si dhe fshati Shashkoc – sipas ndarjes së Zonës kadastrale.
11. **BL 11 - “PRISHTINA E RE 1”** ( Perëndim 1, Qendër 1, Zona QKUK), fillon nga kryqëzimi i rrugës “Kadri Zeka” dhe rrugës “5 Maji”, vazhdon me rrugën “Fehmi Lladrovci”, pastaj vazhdon me rrugën “Çlirimi”, në anën e djathtë të rrugës “Çlirimi” për rrjedhje të përroit, vazhdon me rrugën “Malush Kosova”, vazhdon me rrugën “Mahmut Bakalli”, pastaj në rrugën “Nekibe Kelmendi”, rrugën “Gjilani”, rrugën “Kadri Zeka” deri në kryqëzimin e pikënisjes.
12. **BL 12 - “PRISHTINA E RE 2”**, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës “Nekibe Kelmendi” vazhdon në rrugën “Mahmut Bakalli”, rrugën “Malush Kosova” deri te rrjedha e përroit Matiqani, vazhdon deri te Zona kadastrale Zllatar, vazhdon në anën e djathtë të kufirit kadastral Matiqan - Zllatar, kufirit katastral Matiqan - Hajvali në drejtim të rrugës “Dëshmorët e Gollakut”, vazhdon me rrugën “Pavarsia”, rr. “Nekibe Kelmendi”, deri te pikënisja kryqëzimi i rrugës “Nekibe Kelmendi” me rr. “Mahmut Bakalli”.
13. **BL 13 - “MATI 1”**- Jugu, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës “Bahri Fazliu”, rr. “Ali Aliu Kelmendi”, rr. “Raif Pollomi”, rr. “Malush Kosova”, deri te përroi i Matiqanit, vazhdon përgjatë rrjedhjes së përroit deri te pika ku bashkohet me rrjedhën e përroit tjetër nga ana e djathtë, vazhdon përgjatë atij përroi deri në kryqëzim me rrugën “Bahri Fazliu” deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Ali Aliu Kelmendi”.
14. **BL 14 - “MATI 2”- Veriu**, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës “Ali Aliu Kelmendi” dhe rr “Agron Rrahmani”, vazhdon në rrugën



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



“Xheladin Hana”, rr. “Isa Kastrati”, rr. “Sokol Sopi”, vazhdon me rrugën “Qëndresa”, rr. “Afërdita”, rr. “Skënder Matallari”, lidhet prapë me rrugën “Sokol Sopi”, rr. “Struga”, rr. “Fatmir Ndoçi”, vazhdon përgjatë rrjedhës së përroit në drejtim të rrugës “Muharrem Fejza”, në anenë e djathtë vazhdon me rrugën “Ali Aliu Kelmendi”, vazhdon deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Agron Rrahmani”.

15. **BL 15 - “MATI 3” (Mati i Vjetër)**, Filllon nga kryqëzimi i rrugës “Afërdita”, rr. “Qëndresa” vazhdon përgjatë rrugës Qëndresa deri në kufirin e Zonës kadastral të Zllatarit, vazhdon deri te përroi në Matiqan, vazhdon në kufi me këshillin lokal Prishtina e Re 2, vazhdon me rrugën “Faton Shabani”, rr. “Muharrem Fejza”, përgjatë përroit, rr. “Fatmir Ndoçi”, rr. “Struga”, rr. “Sokol Sopi”, rr. “Skënder Matallari”, rr. “Afërdita” deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Qëndresa”.
16. **BL 16 - “Kodra e Diellit”**, përfshin territorin nga kryqëzimi i rrugës “Afrim Zhitija”, rr “Edmond Hoxha”, rr. “Enver Maloku” vazhdon me rr. “Bahri Fazliu”, rr. “Çlirimi”, rruga “Gjevë Ldrovci”, rr. “Afrim Zhitia” deri në pikën fillestare në kryqëzimin me rrugën “Edmon Hoxha”.
17. **BL 17 - “Aktashi”** përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi me rrugën “Agim Ramadani”, rr. “Arkitekt Karl Gega”, vazhdon me rrugën “Ali Pashë Tepelena”, rr. “Gazmend Zajmi”, rr. “Rrahim Beqiri”, vazhdon me rrugën “Agron Rrahmani”, rr. “Enver Maloku”, rr. “Edmond Hoxha”, rr. “Agim Ramadani” deri te pika fillestare me rrugën “Arkitekt Karl Gega”.
18. **BL 18 - Lagjja e Muhaxhirëve**, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës “Agim Ramadani”, rr “Rrustem Statovci”, rr. “Isa Kastrati”, vazhdon me rrugën “Xheladin Hana”, rr. “Rrahim Beqiri”, rrugën “Gazmend Zajmi”, rr. “Ali Pashë Tepelena”, rruga “Arkitekt Karl Gega”, rruga “Agim Ramadani” deri te kryqëzimi fillestar rruga “Agim Ramadani” dhe rr. “Rrustem Statovci”.
19. **BL 19 - “Dodona”**, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës “Agim Ramadani” me rr. “Ibrahim Lutfiu”, vazhdon me rr. “Ibrahim Lutfiu”, rr. “Nazim Gafurri”, rr. “1 Tetori”, rr. “Rrustem Statovci”, deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Agim Ramadani” dhe rr. “Ibrahim Lutfiu”.
20. **BL 20 - “Sofalia”**, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës “1 Tetori”, rr. “Nazim Gafurr” i vazhdon me rrugën “Nazim Gafurri”, rr. “Shpëtim Robaj”, komplet Zona kadastrale Sofalia me pjesën jugore, duke u





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

kufizuar me pjesën jugore, bl. Mati 2, gjegjesisht rruga “Qëndresa”, rr “Isa Kastrati”, rr “Rrustem Statovci”, rr. “1 Tetori”, deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Nazim Gafurri”.

21. **BL 21 - “Taslixhe”**, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës “Haxhi Zeka”, vazhdon me rrugën “Shemsi Mramori”, rr. “Aqif Blyta”, rr. “Demë Ahmeti”, rr “ Xhavit Ahmeti”, rr. “Nazim Gafurri”, deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Haxhi Zeka”.
22. **BL 22 - “Vreshtat”**, përfshin territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës “Shkëlzen Haradinaj”, me rrugën “Aqif Blyta”, vazhdon me rrugën “Shkëlzen Haradinaj”, rr. “Ismet Asllani”, vazhdon me kufirin kadastra Prishtinë – Kolovicë, pastaj Prishtinë – Sofali, vazhdon me rrugën “Shpëtim Robaj”, rrugën, “Xhavit Ahmeti, vazhdon përmes rrjedhës se përroskës duke u lidhur me rrugën “Aqif Blyta” deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Shkëlzen Haradinaj”.
23. **BL 23 - “Medreseja”**, përfshinë territorin nga kryqëzimi i rrugës “Ilir Konushefci” me rrugën “Bajram Bahtiri”, vazhdon me rrugën “Bajrma Bahtiri”, rrugën “Murat Xhakja”, rrugën “Hasan Remniku”, rr. “Shemsi Mramori”, rr. “Haxhi Zeka”, rr “Ibrahim Lutfiu”, vazhdon me rrugën “Agim Ramadani”, rr “Ilir Konushefci”, deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Bajram Bahtiri”.
24. **BL 24 - “Kolovica”**, përfshinë territorin nga kryqëzimi i rrugës “Basri Canolli”, rr. “Murat Xhakja”, rr. “Basri Canolli”, rr. “Gollaku”, duke u kthyer ne anën e djathtë përgjatë kufirit kadastral Kolovicë – Llukar, vazhdon me rrugën “Mujdin Alija”, rr “Mukadeze Lika”, me anën jugore Prishtinë – Kolovicë, rruga “Ismet Asllani”, rr. “Shkëlzen Haradinaj”, rr. ‘ Hasan Remniku”, rr. “Murat Xhakja”, deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Basri Canolli”.
25. **BL 25 - “Kodra e Trimave 1”**, përfshinë territorin nga kryqëzimi i rrugës “Sami Plakolli”, rr. “Ahmet Dërguti”, rr. “Plava”, rr. “Qemal Stafa”, rr. “Bardhok Biba”, ne anën e djathtë vazhdon me kufirin kadastral Shkabaj, rruga “Batalioni Atlantikut”, rr. “Agim Osaj, rr. “Mon Balaj”, rr. “Fahri Fazliu”, deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën “Sami Plakolli”.
26. **BL 26 - “Kodra e Trimave 2”**, ana e djathtë, pjesa lindore përfshinë territorin nga kryqëzimi i rrugës “Bajram Bahtiri”, rr. “Fahri Fazliu”, rr. “Mon Balaj”, rr. “Dalip Alshiqi”, rr “Sabri Godo”, rr. “Fieri”, rr. “Berit Beker”, rr. “Basri



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



- 
- Canolli", rr. "Bajram Bahtiri", deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën "Fahri Fazliu".
27. **BL 27 - "Arbëria 1"**, përfshinë territorin nga kryqëzimi i rrugës "Ahmet Dërguti" me rrugën "Zagrebi", vazhdon me rrugën "Tirana", rrugën "Hekurudha", rr. "Bardhosh Gërvalla", rr "Mitrovica", rr. "Gjergj Ballsha", rr. "Stanbolli", rr "Selman Lajqi", rr. "Ahmet Dërguti", deri te pika fillestare ku kryqëzohet me rrugën "Zagrebi".
28. **BL 28 - "Arbëria 2"**, përfshinë territorin nga kryqëzimi i rrugës "Bardhosh Gërvalla", rruga "Lidhja e Pejës", deri te kufiri komunal Prishtinë – Fushë-Kosovë, vazhdon me kufirin kadastral Prishtinë - Shkabaj, rruga "Lekë Matrënga", rruga "Mitrovica", rr. "Bardhosh Gërvalla" deri në pikën fillestare rruga "Lidhja e Pejës".
29. **BL 29 - Shkabaj**, përfshinë territorin duke filluar nga kryqëzimi i rrugës "Mitrovica", duke vazhduar me rrugën "Lekë Matrënga", kufiri kadastral Prishtinë – Shkabaj, duke vazhduar me kufirin komunal Prishtinë – Fushë-Kosovë, duke vazhduar me kufirin Prishtinë – Obiliq, vazhdon me kufirin kadastral Prishtinë - Shkabaj, rruga "Bardhok Biba", rruga "Qemal Stafa", rruga "Selman Lajqi", rr. "Stambolli", rr. "Gjergj Ballsha", deri në pikën fillestare te rruga "Mitrovica".
30. **BL 30 - Bërnice e Poshtme:**( ish-Jugoviq ) dhe Bardhosh, sipas ndarjes së zonave kadastrale.
31. **BL 31 – Bërnice e Epërme**, ndarja sipas zonës kadastrale.
32. **BL 32 - Trudë**, Lebanë, ndarja sipas zonës kadastrale.
33. **BL 33 – Barilevë**, Drenoc, ndarja sipas zonës kadastrale.
34. **BL 34 – Besi**, Vranidoll ,Teneshdoll, Rimanishtë.
35. **BL 35 – Prugoc**.
36. **BL 36 - LLukar**, Makovc ,Grashticë, Radashec, Siqevë, Sharban.
37. **BL 37 - Koliq**.
38. **BL 38 - Keqekollë**, Ballaban, Nishec, Prapashticë, sipas zonës kadastrale.
39. **BL 39 - Dabishec**, Hajkobillë, Gllogovicë, sipas zonës kadastrale.
40. **BL 40 – Marevc**.
41. **BL 41 - Mramor**, Busi , Novosellë.
42. **BL 42 - Slivovë**, Kukavicë, Dragoc.

**Ndarja e zonave kufizuese është bazuar në këto kritere:**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



- 
1. Sipërfaqja e territorit;
  2. Numri i banorëve;
  3. Largësia nga Qendra - rrezja në largësi deri në 800 m;
  4. Shtrirja gjeografike, me vijat komunikative të rrugëve;
  5. Gjendja faktike në terren.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



ANNEX 3

EMËRTIMET E RRUGËVE QË I PËRKASIN SECILËS BASHKËSIE LOKALE

	BASHKËSITË LOKALE URBANE	BASHKËSITË LOKALE RURALE	GJITHSEJ
Numri i bashkësive lokale (BL-ve)	29	13	42
Numri i rrugëve	1735	594	2329
Sipërfaqja e territorit (km <sup>2</sup> )	82.38	441.43	523.81

BASHKËSITË LOKALE URBANE:

Nr. rendor	Numri i Bashkësisë Lokale	Bashkësia Lokale Urbane	Numri i rrugëve	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )
1	I	BL "Qendra"	35	0.71
2	II	BL "Pejton - Lakërishta"	29	0.58
3	III	BL "Dardania"	32	0.57
4	IV	BL "Ulpiana"	28	0.39
5	V	BL "Tophane"	32	0.30
6	VI	BL "Kalabria 1"	47	3.00
7	VII	BL "Kalabria 2"	60	2.67
8	VIII	BL "Çagllavica 1"	74	2.95
9	IX	BL "Çagllavica 2"	85	1.79
10	X	BL "Hajvalia"	144	10.99
11	XI	BL "Prishtina e Re 1"	76	2.67
12	XII	BL "Prishtina e Re 2"	35	3.99
13	XII	BL "Mati 1" - Jugu	51	0.85
14	XIV	BL "Mati 2" – Veriu	68	1.50
15	XV	BL "Mati 3" (Mati i Vjetër)	83	10.66
16	XVI	BL "Kodra e Diellit"	22	0.59
17	XVII	BL "Aktashi"	37	0.39
18	XVIII	BL "Lagjja e Muhaxhirëve"	44	0.54
19	XIX	BL "Dodona"	52	0.70
20	XX	BL "Sofalia"	75	9.85
21	XXI	BL "Taslixhe"	103	1.23
22	XXII	BL "Vreshtat"	38	1.17
23	XXIII	BL "Medrese"	79	0.82



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

24	XXIV	BL “Kolovicë”	36	7.33
25	XXV	BL “Kodra e Trimave 1”	113	4.89
26	XXVI	BL “Kodra e Trimave 2”	144	2.65
27	XXVII	BL “Arbëria 1”	55	2.04
28	XXVIII	BL “Arbëria 2”	22	2.89
29	XXIX	BL “Shkabaj”	36	3.56

**BASHKËSITË LOKALE RURALE:**

Nr. rendor	Numri i Bashkësisë Lokale	Bashkësia Lokale rurale	Numri i rrugëve	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )
1	XXX	BL Bërnice e Poshtme	73	13.55
2	XXXI	BL Bërnice e Epërme	57	8.26
3	XXXII	BL Trudë	29	8.04
4	XXXIII	BL Barilevë	49	12.57
5	XXXIV	BL Besi	44	28.03
6	XXXV	BL Prugoc	47	3.97
7	XXXVI	BL Llukar	57	61.22
8	XXXVII	BL Koliq	21	39.9
9	XXXVIII	BL Keqekollë	65	82.28
10	XXXIX	BL Dabishec	22	26.46
11	XL	BL Marec	45	72.8
12	XLI	BL Mramor	67	63.55
13	XLII	BL Slivovë	18	20.79



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EMËRTIMET E RRUGËVE

Kodi i rrugës	Emri i rrugës	BL në Zonën Urbane	BL në Zonën Rurale
19_10120	DËSHMORËT E MARECIT	BL "Mati 1" - Veri	
19_10131	SOKOL SOPI	BL "Mati 1" - Veri	
19_10255	ISA KASTRATI	BL "Mati 1" - Veri	
19_10333	MANASTIRI	BL "Mati 1" - Veri	
19_10360	MENSUR ZYBERAJ	BL "Mati 1" - Veri	
19_10381	MUHARREM FEJZA	BL "Mati 1" - Veri	
19_10421	NDUE PËRLLESHI	BL "Mati 1" - Veri	
19_10454	QËNDRESA	BL "Mati 1" - Veri	
19_10498	SALI ABAZI	BL "Mati 1" - Veri	
19_10524	SHAQIR IGRISHTA	BL "Mati 1" - Veri	
19_10546	STRUGA	BL "Mati 1" - Veri	
19_10612	XHELADIN HANA	BL "Mati 1" - Veri	
19_12002	AGRON RRAHMANI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12773	ABDURRAHIM BUZA	BL "Mati 1" - Veri	
19_12775	ISUF SOKOLI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12838	ALI SOKOLI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12839	PARASHQEVI QIRIAZI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12840	IBE PALIKUQI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12841	SHEFIK MIFTARI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12842	FATBARDHA GEGA	BL "Mati 1" - Veri	
19_12843	HYSNI XHEMAJLI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12844	KRISTO LUARASI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12846	BRAHIM ADEMI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12847	FRANÇESKO BIDER	BL "Mati 1" - Veri	
19_12849	DUKAGJIN VULA	BL "Mati 1" - Veri	
19_12850	KRAJA	BL "Mati 1" - Veri	
19_12851	BISTRICA ILIRE	BL "Mati 1" - Veri	
19_12852	ISMAJL LUMA	BL "Mati 1" - Veri	
19_12853	RUZHDI SALIU	BL "Mati 1" - Veri	
19_12854	RAMADAN KASTRATI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12855	TUZI	BL "Mati 1" - Veri	
19_12856	FEHMI RAMA	BL "Mati 1" - Veri	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



<b>Kodi i rrugës</b>	<b>Emri i rrugës</b>	<b>BL në Zonën Urbane</b>	<b>BL në Zonën Rurale</b>
19_12857	<b>DHIMITËR FULLANI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12859	<b>ABUSH LOKU</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12860	<b>PËRPARIM THAÇI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12861	<b>HAMDI HAJRIZI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12862	<b>BORSHI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12866	<b>BEQIR GASHI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12867	<b>HËNA SPAHIU</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12871	<b>XHAVIT BAJRAKTARI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12872	<b>BRANKO HORVAT</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12873	<b>AGUSH ISUFI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12874	<b>RIDVAN QAZIMI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12875	<b>ZEF LUSH MARKU</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12876	<b>ADNAN MALIQI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12877	<b>ANA KOMENA</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12879	<b>MITRUSH KUTELI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12881	<b>PESHKOPIA</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12882	<b>RAIF HALITI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12883	<b>SKËNDER GASHI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12886	<b>XHAVIT KOZHANI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12888	<b>ENVER OLLURI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12890	<b>NAZMI PACOLLI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12891	<b>SHPRESA TUDA</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12892	<b>NIKOLLË KETA</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12910	<b>HEROINAT E MIRDITËS</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12913	<b>SKIFTER ARIFI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12914	<b>SADRI KULLECI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12915	<b>SKËNDER MATALLARI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12916	<b>LIRIE JASHARI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12919	<b>GËZIM DERVISHAJ</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12920	<b>AZEM BEHLULI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12921	<b>ÇAMËRIA</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12924	<b>NEZIR HASAN GASHI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12925	<b>BASHKIM KABASHI</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12926	<b>DRITON KRIVAÇA</b>	BL “Mati 1” - Veri	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



<b>Kodi i rrugës</b>	<b>Emri i rrugës</b>	<b>BL në Zonën Urbane</b>	<b>BL në Zonën Rurale</b>
19_12927	<b>DRITA PELINGU</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_12936	<b>PUKA</b>	BL “Mati 1” - Veri	
19_10011	<b>ABDYL FRASHËRI</b>	BL “Aktash”	
19_10026	<b>2 NËNTORI</b>	BL “Aktash”	
19_10032	<b>AGIM RAMADANI</b>	BL “Aktash”	
19_10049	<b>ALI KELMENDI</b>	BL “Aktash”	
19_10051	<b>ALI PASHË TEPELENA</b>	BL “Aktash”	
19_10054	<b>ANTON ÇETTA</b>	BL “Aktash”	
19_10062	<b>ARMEND DACI</b>	BL “Aktash”	
19_10116	<b>DERVISH ROZHAJA</b>	BL “Aktash”	
19_10147	<b>ENVER MALOKU</b>	BL “Aktash”	
19_10149	<b>EQREM ÇABEJ</b>	BL “Aktash”	
19_10149	<b>EQREM ÇABEJ</b>	BL “Aktash”	
19_10169	<b>FERHAT DRAGAJ</b>	BL “Aktash”	
19_10177	<b>FLORIM YMERI</b>	BL “Aktash”	
19_10179	<b>GANIMETE TËRBESHI</b>	BL “Aktash”	
19_10182	<b>GAZMEND ZAJMI</b>	BL “Aktash”	
19_10201	<b>HAJRULLAH ABDULLAHU</b>	BL “Aktash”	
19_10223	<b>HILMI RAKOVICA</b>	BL “Aktash”	
19_10232	<b>EDMOND HOXHA</b>	BL “Aktash”	
19_10375	<b>UKË BYTYÇI</b>	BL “Aktash”	
19_10475	<b>REXHEP MALA</b>	BL “Aktash”	
19_10481	<b>QAZIM BOBAJ</b>	BL “Aktash”	
19_10524	<b>SHAQIR IGRISHTA</b>	BL “Aktash”	
19_10565	<b>THIMI MITKO</b>	BL “Aktash”	
19_10593	<b>VËLLEZËRIT GËRVALLA</b>	BL “Aktash”	
19_10615	<b>XHELADIN REKALIU</b>	BL “Aktash”	
19_11029	<b>BUSHATASIT</b>	BL “Aktash”	
19_11030	<b>KUSHTRIMI</b>	BL “Aktash”	
19_11031	<b>FITNETE REXHA</b>	BL “Aktash”	
19_11032	<b>GJYZEPE MAGIO</b>	BL “Aktash”	
19_11033	<b>JASHAR REXHEPAGIQI</b>	BL “Aktash”	
19_11281	<b>AFRIM ZHITIA</b>	BL “Aktash”	
19_11502	<b>RRAHIM BEQIRI</b>	BL “Aktash”	





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



<b>Kodi i rrugës</b>	<b>Emri i rrugës</b>	<b>BL në Zonën Urbane</b>	<b>BL në Zonën Rurale</b>
19_12002	<b>AGRON RRAHMANI</b>	BL “Aktash”	
19_12782	<b>SHOTË GALICA</b>	BL “Aktash”	
19_12784	<b>PJETËR BUDI</b>	BL “Aktash”	
19_12822	<b>SHARL DE GOL</b>	BL “Aktash”	
19_12824	<b>BISLIM ZEKOLLI</b>	BL “Aktash”	
19_10008	<b>VUDRO VILSON</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10009	<b>ARBEN XHELADINI</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10022	<b>AFRIM GASHI</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10039	<b>AHMET KRASNIQI</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10071	<b>AZEM JASHANICA</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10077	<b>BAJRAM CURRI</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10092	<b>BEKIM BERISHA</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10124	<b>DËSHMORËT E SHARBANIT</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10139	<b>EDUARD LIR</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10158	<b>FADIL BALA</b>	BL “Arbëria 1”	
19_10170	<b>FERID CURRI</b>	BL “Arbëria 1”	
